E enjte, 18 maj 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare, thërrisni çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Jemi në seancë të hapur.

Z. KEHOE: [Përkthim] Përpara se të kalojmë në seancë private kam një koment për Gjykatën.

Sipas urdhrit tuaj dje për zhvillimin e procesit në seancë private, të hapur, të mbyllur. Dua që paraqes disa vështirësi për dijeninë tuaj.

Siç e keni vënë re, i kemi kundërshtuar të gjitha masat e përdorura nga ZPS-ja për seanca të hapura, të mbyllura, masa mbrojtëse.

Por, dua t'ju tërheq vëmendje ndaj faktit se jo vetëm e kundërshtojmë sepse duam që procedurat duhet të mbahen të hapura, të merret vesh e vërteta, por kemi edhe shqetësime praktike në ndjekjen e metodave të përdorura nga ZPS-ja.

Ata e kanë mundësinë të futen të dalin në seanca, si mbas dëshirës apo fakteve individuale. Si Mbrojtës, ne, për ne Mbrojtësit, është shumë e vështirë që t'i bëjmë pyetjet tona, kur të na vijë radha, duke kaluar sa ke njëra te tjetra. Kjo është një çështje praktike, shumë praktike në fakt. Unë ngrihem në emër të ekipit, sepse do të kemi dhe ne, do kemi dëshmitarë të ndryshëm, jo vetëm ky tani, kemi dhe dy tjerë që kanë masa mbrojtëse të mëdha. Pra, është një shqetësim praktik.

Dhe kur ka ndodhur e do të ndodhë, pyetjet e këtyre dëshmitarëve nga ana jonë, do të pasohen kryesisht nga ato që do të bëjë Prokuroria në seanca të hapura. Kam frikë se do të kemi shumë pak pyetje për t'i bërë sepse është vështirë, për këto arsye që sapo thashë.

Pra, është një shqetësim shumë real nga ana jonë si Mbrojtje që publiku të kuptojë se për çfarë pyesim ne, duke pasë parasysh gjithë këto vështirësi. Prandaj dhe kërkojmë që të jemi në seancë të hapur, pra, procedura është shumë më e vështirë nga ana jonë sesa nga ana e Prokuroria mendoj. Pra, është shqetësim praktik.

Ne punojmë sigurisht në bazë të urdhrave tuaja, udhëzimeve tuaja, por e ndjemë të nevojshme ta ngremë këtë shqetësim, duke pasur parasysh se ZPS-ja ka kërkuar masa mbrojtëse për të gjithë dëshmitarët, prandaj deshëm t'jua vëmë në dijeni shqetësimin tonë.

Aspekti i dytë është që duke pritur për një periudhë kohe, është dëshmitar i pestë. Kemi dhe gjashtën dhe shtatën që, po ashtu, kanë masa mbrojtëse. Pra, janë shtatë dëshmitarët e parë që kanë masa mbrojtëse që do të zhvillohen për arsye procedurat në seancë private. Nga ne pritet që të vlerësojmë dy dëshmitarët e tjerë, se janë dhe dy në këtë bllok dëshmitarësh që kanë masa mbrojtëse të mëdha, për të parë nëse janë absolutisht të nevojshme këto masa mbrojtëse apo bazohen në një farë shqetësimi që mund të ketë Prokuroria, që kemi parë deri tani.

Dhe kjo kur të mbarojmë këtë bllok të kemi mundësi që disa prej tyre t'i bëjmë në seanca të hapura dhe jo gjithë kohës në seanca të mbyllura.

Faleminderit shumë. Desha që t'jua vija në vëmendje.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në qoftë se mund të flas dhe unë në përgjigje. Ka disa shqetësime.

Siç e dini dhe e thamë dhe për procesverbal, masat mbrojtëse janë marrë në bazë të kërkesave tona të marra, pra, nga Trupi Gjykues ku i kemi vënë në dukje arsyet dhe ju keni marrë vendimet.

Gjithashtu, shqetësimet kryesore nuk vijnë nga ne. Po vijnë nga frika, frikësimi i dëshmitarëve, të cilat janë gjëra të cilat janë gjëra që nuk i kontrollojmë dot ne si Prokurori. Pra, po të kishim mundësi t'i parandalonim, do t'i bënim.

Së fundi, përveç një dëshmitari deri tani, të gjithë

dëshmitarët kanë dëshmuar në disa pjesë publikisht ka pasur dhe raste kur ZPS-ja ka kërkuar të kalojmë në seancë publike dhe Mbrojtja ka thënë që nuk është e përgatitur ta bëjë këtë. Ne e vlerësojmë këtë kur kjo bëhet për mbrojtjen e dëshmitarëve, por është paraqitur sikur është një çështje që varet vetëm nga ne krejtësisht, por nuk është.

Z. KEHOE: [Përkthim] Është shumë shkurt. Është vetëm nga ana juaj. Ne e kemi kundërshtuar, Është vetëm e njëanshme. Ne e kemi kundërshtuar, kemi vite që kundërshtojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I the këto.

Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, ideja është ne e dimë cila është [e pakuptueshme] bazë. Pra ne nuk pajtohemi me atë qëndrim dhe duam t'i zhvillojmë në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Lexojini edhe një herë ato që lexuam dje. Ne nuk po fajësojmë asnjërin prej juve. Ne duam që, ju vetë, të dilni me metoda praktike. Nuk ka nevojë për komente. Nëse s'e bëni dot, do ta bëjmë ne si Trupi Gjykues. Por ne po ua kërkojmë ju, se do të mendoj që do të jetë një zgjidhje më e mirë.

Z. KEHOE: [Përkthim] E kemi përpjekur ta bëjmë në rastin e shumë dëshmitarëve. Neve sigurisht do bëjmë atë që na jepet si urdhër por do t'i shprehim shqetësimet tona.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe Mbrojtësi i Viktimave donte të bënte një koment.

Z. LAWS: [Përkthim] Mi morët nga goja ato që do të thoja.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

Është një çështje që duhet ta diskutojmë midis palëve. Por në emër të viktimave pjesëmarrëse do të ishte shumë e gabuar që njeriu të krijojë përshtypjen që ZPS-ja i ka përdorur seancat private për arsye që nuk janë të mirëbazuara.

Siç e dinë të gjithë, ka një klimë reale frikësimi nga ana e viktimave për të cilët janë marrë masa mbrojtëse të cilat mendoj që janë të nevojshme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kimi parasysh që kemi një organizim ku, një organizim për mbrojtjen e dëshmitarëve, që kanë vetëm një detyrë të merren me dëshmitarët, të bëjnë rekomandime dhe këto rekomandime bëhen rregullisht për çdo dëshmitar, sigurisht, duhet të marrim parasysh këto rekomandime. Ndonjëherë i ndjekim plotësisht, ndonjëherë i ndryshojmë, ndonjëherë nuk i ndjekim. Por ky është një proces.

Znj. Q'Reilly.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua ta bëj të qartë se jemi përpjekur të zhvillojmë diskutime midis palëve me ZPS-në për të marrë disa materiale më herët dhe për të minimizuar redaktimet që ne të hetojmë dhe të paraqesim çështjen tonë. Nuk ka qenë e dobishme.

Kështu që e marrim plotësisht atë që na thatë dje dhe nuk është një lojë për të fajësuar njërën palë apo tjetrën, por në këtë moment presim një shqyrtim më të hollësishëm nga Gjykatësit. Se mbase juve keni nevojë të ndërhyni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Përpara sesa të vazhdojmë me dëshmitarin, dua të trajtojmë një çështje kur ZPS-ja ofroi deklaratat dhe provat e lidhura me të me numër 03165. Mbrojtësi i z. Veseli e kundërshtoi pranimin e dy dokumenteve *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*

Këto dokumente janë konstatuar të përshtatshme për pranim në vendimin e Trupit Gjykues F0138 në paragrafin 126. Kundërshtime për pranimin e tyre të ngritura nga Mbrojtja në parashtrimin e tyre F01308 janë trajtuar nga Trupi Gjykues dhe është dhënë vendim lidhur me to.

Pasi të pranohen dhe deklarohen të pranueshme, pranimi i një prove mund të kundërshtohet me anë të një rregulli tjetër në bazë të rregullës 79.

Për sa i takon komenteve të djeshme për ta rishikuar vendimin për pranim kërkesat për ripranim nuk janë treguar se janë plotësuar lidhur me këto dokumente.

Prandaj Trupi Gjykues e bën të qartë se këto dy nene ishin të përshtatshme për pranim sipas vendimit F01380 dhe janë pranuar. Nuk do të dëgjohen më parashtrime lidhur me pranimin e tyre.

Trupi Gjykues konstaton më tej se tre dokumente të tjera që lidhet me *[REDAKTUAR]* varen nga një kërkesë

jo gojore për pranim. Kundërshtimi për pranimin e tyre është bërë nga Mbrojtja në konstatimin F1387.

Trupi Gjykues i ka marrë dhe po shqyrton dhe do të japë një vendim në lidhje me këto tre dokumente të tjera në momentin e duhur.

I lutem Sekretares të rikonfirmojë numrin që u është dhënë dy dokumenteve të cilët janë pranuar si prova të lidhura me një numër P.

Sekretare.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto dokumente që janë me numër *[REDAKTUAR]* do të marrin numrin P90.1.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni koment znj. O'Reilly?

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po. Dua ta kuptoj. Pra, tani janë pranuar dy artikuj?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Në rregull.

Kërkesa e vetme që kam është që ka dy dokumente që kanë shumë rëndësi për të kuptuar kontekstin e këtyre dokumenteve. Nuk janë dokumente për të cilat dëshmitari mund të dëshmojë, përveç se ai ka qenë dëshmitar në dy aktgjykime, ku është dëgjuar shumë dëshmi lidhur me këto dokumente. Prandaj dua që ta paraqes si provë materiale aktgjykimin e apelit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta marrim

vendimin më vonë për këtë.

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 3165.

Znj. Mayer, do t'i përfundoni pyetjet në fund të kësaj seance?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Shumë përpara kësaj kohe.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Znj. O'Reilly, duhet që të paraqisni një mocion jo gojor apo dokumente të shkruara që t'i paraqisni dokumentet në kohën e duhur. Nuk është ky momenti i duhur.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar. Sot do të vazhdojmë me pyetjet që do t'ju bëj ZPS-ja. Ju kujtoj që të përpiqeni t'i përgjigjeni pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Kur nuk e kuptoni një pyetje, mos ngurroni të pyesni t'jua përsërisnin dhe ata do të përpiqen t'jua sqarojnë.

Gjithashtu, kujtoni që të vini në dukje ku i mbështesni ato që thoni, pra, faktet, rrethanat, për të cilat do t'ju pyesim.

Ju kujtoj që jeni ende nën betim siç deklaruat kur bëtë betimin solemn.

Mos harro të flasësh pranë mikrofonit, të presësh pesë

sekonda përpara sesa të përgjigjesh dhe të flasësh me ngadalë që t'ju përkthejnë përkthyesit.

Në qoftë se keni nevojë të bëni pushime, vijeni në dukje dhe ne do t'ua plotësojmë.

Së fundi, mos flisni në qoftë se unë jua bëj me shenjë kur ngre unë dorën.

Znj. Mayer, mund të vazhdoni pyetjet e drejtpërdrejta.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Faleminderit.

DËSHMITARI: W03165 [Vijon]

Pyetje nga znj. Mayer: [Vazhdim]

ZNJ. MAYER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, po ju kujtoj që jemi në seancë të hapur dhe të mos përmendni emra, gjëra konkrete siç i thamë dje për mbrojtjen tuaj. E kuptoni këtë që po ju them?

PË. Po.

PY. Dje e lamë kur po flisnim për faktin që anëtarët e UÇK-së morën të afërmin tuaj. Kur këta e morën të afërmin tuaj, ti i shkove mbrapa atyre?

PË. Po.

PY. Pse i shkove mbrapa?

PË. Për të këqyrë çka u bë, pse i morën.

PY. Kur po i ndiqje, kur po i shkoje mbrapa a pe ndonjë polic serb?

PË. Jo.

PY. Po forca ushtarake serbe pe gjë gjatë rrugës?

PË. Jo.
PY. Mbas pak erdhe tek një vend ku duhej të merrje vendim cilën rrugë të ndiqje, nga të shkoje kështu?
PË. Po.
PY. A mund të thoje se ç'kishte nga secila rrugë apo drejtim që do merrje?
PË. Po. Po mendon para se me marrë makinën me ju ly mbrapa apo kur e kanë marrë të afërmit e mi, i kanë hyp në kerr dhe në rrugën trup që kam dalë përpara?
PY. Po ta sqaroj. Kam parasysh mbasi e morën të afërmin tënd dhe ti more kerrin, kur shkove deri në një vend dhe aty t'u desh që të marrësh vendim, të shkoje rrugën trup apo rrugën tjetër, pa thënë emra, a mund të na shpjegosh se çfarë kishte në secilin drejtim, në secilën rrugë?
PË. Po, pasi e ka marrë kerrin, e kam marr dhe armën edhe ju kam ly kerrit që i kanë marrë të afërmit e mi, me maska. Edhe në dalje të fshatit i kishin zbritë dy të afërmit të mi nga makina *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
PY. Zotëri, mos harro që jemi në seancë të hapur, mos përmend emra fshatrash apo ndonjë gjë konkrete, emër konkret për të afërmit.
PY. Unë po të pyes, e di që është vetëm një pjesë e asaj që ndodhi. Po përqendrohu tek kjo që po të them. Erdhi një moment

ku t'u desh të marrësh një vendim, a të kthehesh nga rruga trup apo nga rruga tjetër për të gjetur të afërmin tënd?

PË. Po, për të gjetë të afërmin nga rruga trup.

PY. Pasi more këtë rrugën e shkurtër apo trup, pasi pe njerëz në rrugë, a t'u desh që të marrësh vendim se cilën rrugë të ndjekësh?

PË. Po.

PY. Po të ishe kthyer majtas çfarë kishte? Po të kishe kthyer djathtas do të ishin të njëjtit njerëz, pra, çfarë kishte njëra rrugë dhe çfarë kishte rruga tjetër?

PË. Rruga të majtas ishte më trup për me i dalë përpara për me desh me ndalë, mi ndal të afërmit e mi. Rruga në të djathtë ishke ma larg edhe të njëjta, e njëjta mënyrë a kanë për më i ndalë, po ja kam mbajt në rrugën e majtë për ma afër me ndal krimin. Me i ndalë të afërmit e mi.

PY. Pastaj duhet të merrje vendim atë kaloje nga zona që kontrollohej nga serbët apo nga zona që kontrollohej nga UÇK-ja? Tu desh ta marrësh këtë vendim?

PË. Po.

PY. Kur erdhe ke ajo pikë nga cila anë more, cilin drejtim more, cilin drejtim more, nga cila anë u ktheve?

PË. Nga ana e djathtë në dalje të fshatit.

PY. Kush e kontrollonte atë anën që more ti?

PË. Aty nuk kishke polic. Policia ishin nga fshati 8 kilometra larg.

PY. Pyetja që po të bëj është kjo, kjo zonë, pra, aty ku u
ktheve ti ishte nën kontroll të UÇK-së apo të serbëve?
PË. Këtë ma shumë në atë kohë të UÇK-së.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj që të kalojmë në seancë private, të nderuar Gjykatës.

Sepse ka informacion konkret të cilin nuk e shmang dot.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F1654*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

ZNJ. MAYER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, dua të kthehemi pak pas në kohë. Përpara se të
vije tek ky vendi ku more vendim nga të kaloje, kur po ndiqje
makinën, veturën që ku ishte *[REDAKTUAR]* rrugës a pe njeri, a
takove njeri?
PË. Po.
PY. Kush ishte ai?
PË. Ishin dy ushtarë të UÇK-së me maska dhe me armë.
PY. Ti ishe në makinë kur i pe apo jashtë makinës?
PË. Jo, unë isha njëherë në këmbë, jashtë makinës.
PY. Përqendrohu, mbasi u fute në makinë dhe fillove të
vozisësh edhe kur dy të afërmit *[REDAKTUAR]*. Kur
i pe ti këta vazhdove të vozishësh makinën për t’u përpjekur
të gjesh *[REDAKTUAR]*
PË. Po

PY. Në atë kohë hase, takove njeri në rrugë?
PË. Po.
PY. Kush ishin?
PË. Por kur ju kam ly makinës mbrapa *[REDAKTUAR]* që e morra që e kishin zbrite *[REDAKTUAR]*, në dalje të fshatit, rrugës për Banjë, *[REDAKTUAR]*, e kam taku *[REDAKTUAR]* me një person tjetër, meqenëse nuk e kam njoftë në atë kohë si e ka pasë emrin, ma vonë e kam marrë vesh kush ka qenë.
PY. Pra, kur e mësove më vonë si quhej ky personi tjetër?
PË. Ky quhej *[REDAKTUAR]*
PY. Si ishin veshur *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]*, çfarë kishin vesh?
PË. Tesha të njëjta të zeza sukur ata vrasësit që kanë qenë.
PY. A e di ti nëse *[REDAKTUAR]* ishte anëtar i UÇK-së?
PË. Po.
PY. Ishte?
PË. Po.
PY. Po nga e dije ti këtë?
PË. Po e kishna pa. E kishna pa gjatë luftës edhe ka qenë komandanti i atij terreni.
PY. Dua të vazhdoj pra. Pasi pe *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* pastaj e gjete *[REDAKTUAR]*?
PË. *[REDAKTUAR]* e gjeta pastaj të vramë.
PY. E di që e ke shpjeguar më përpara se në çfarë gjendje *[REDAKTUAR]* gjete. Por gjete ndonjë gjë tjetër *[REDAKTUAR]*?

PË. Po aty kishin qenë *[REDAKTUAR]*. Kish qenë edhe *[REDAKTUAR]* edhe e kam gjet *[REDAKTUAR]*.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju lutem të shohim në ekran P90, faqja konkrete është *[REDAKTUAR]* dhe dokumenti korrespondues është P90.1. Dhe faqja konkrete është 12, por faqja e përkthimit është *[REDAKTUAR]*.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjatë kohës që po bëjnë këtë, duhet të vazhdojmë ende në seancë private? Sepse nuk po shohim ndonjë emër.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po. Është *[REDAKTUAR]* është emri *[REDAKTUAR]* dhe ishte një *[REDAKTUAR]* i cili është në *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*.

PY. Dëshmitar, shiko aty në ekran, a e njeh kopjen e këtij dokumenti, është kjo kopja e atij dokumenti?

PË. Po.

PY. Kjo është *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. A mund t'i thuash Trupit Gjykues se çfarë thotë kjo letër, çfarë akuzash bën ndaj *[REDAKTUAR]*

PË. Po. Këtu shkrun:

*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PY. Mbasi thotë *[REDAKTUAR]* ka bëra akuza ndaj

*[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. A mund ta lexosh këtë që thotë aty?

PË. Po nuk shihet krejt me u lexu. Tash, por *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* Aty për aty veç emrin ja kanë shkru, *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* vetëm emri,
mbiemri dhe fshati, domethënë, *[REDAKTUAR]* ju ka
shkru *[REDAKTUAR]*

ZNJ. MAYER: [Përkthim] I kërkoj Gjykatës të paraqesë një kopje më të lexueshme. Dhe dokumenti tjetër është SPOE00067245 dhe i korrespondon përkthimit që ka të njëjtën numër SPOE00067145-ET.

PY. Dëshmitar, shiko në ekran të lutem. Nuk është edhe kjo shumë e mirë për ta lexuar, po e ke më të lehtë ta lexosh këtë?

PË. Po çka shihet po, por nuk shihen prapë gjysa e rreshtit nuk shihet këtu.

PY. Atëhere po të pyes unë. Çfarë ndodhi kur ti e gjete këtë *[REDAKTUAR]*? E lë aty apo e more me vete?

PË. E mora me vete.

PY. Çfarë bëre me këtë?

PË. Po këtë e morra me vete edhe e mshefa. Se ishke kohë lufte nuk u dike dhe e kam msheh.

PY. Kur e more nga ai vendi, ishte në të njëjtin gjendje apo ishte prishur, ishte dëmtuar?
PË. Jo, ishte dëmtuar pasi e kam shti në dhe’. Kur jam kthy me marrë ishte dëmtu nga lagështia në dhe’. Kur kam marrë tek *[REDAKTUAR]*.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ofroi materialin SPOE00067245 dhe përkthimin anglisht SPOE00067245-ET janë kopje më të lexueshme, më të qarta në numrin P90, P90.1.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni kundërshtime që të pranohet?

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Asnjë.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Asnjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali SPOE00067245 pranohet. Sekretarja do t’i japi numrin.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e provës materiale P92.

ZNJ. MAYER: [Përkthim]

PY. Të shohim dokumentin, Dëshmitar dhe në këtë dokument hidhen akuza për *[REDAKTUAR]* si kolaboracionist. I ke dëgjuar më herët akuza të tilla?
PË. Jo.
PY. Me sa di ti, *[REDAKTUAR]* e përkrahte UÇK-në apo jo?
PË. Po, shumë.
PY. Si e mbështeste shumë? Çfarë bënte pra?
PË. Me financa edhe me tehnik çka kanë lyp, ça ka pasë

nevojë.

PY. Tani dua të tregoj një material tjetër.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Që është me numrin P90. Dhe faqja konkrete ka numrin *[REDAKTUAR]* dhe përkthimi në anglisht është P90.1. Faqja 15 e materialit në PDF dhe faqja apo faqet konkrete janë *[REDAKTUAR]* deri në *[REDAKTUAR]*.

PY. Dëshmitar, shihni ekranin, aty në ekran e sheh këtë artikullin nga *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. Këta artikullin e ka shkruar *[REDAKTUAR]* dhe më përpara keni thënë se pajtoheni me të gjitha gjërat që janë shkruar këtu, kështu?

PË. Po.

PY. Dua të shohim në kolonën në të majtë, nga mesi poshtë, diku thuhet që *[REDAKTUAR]* e ndihmonte Kosovën. Këtu e kishe fjalën kur the që e përkrahte UÇK-në?

PË. UÇK-në e përkrahte me mjete financiare ka dhënë për UÇK-në edhe ka dhënë ça kanë pasë nevojë çisterne se në atëkohë nuk ka pasë sa duhet tehnikë nga na, janë ardhë i kanë marrë në shtëpien tonë, çka do që u ka vy.

PY. Nëse vazhdojmë dhe shohim pak më poshtë në artikull, vazhdojmë në të majtë në të njëjtën kolonë, *[REDAKTUAR]* shkruan se nuk do që të tjerët të vuajnë fatin e tij dhe t'ju vriten *[REDAKTUAR]*, t'ju njollosin nderin dhe t'ua humbin ardhmërinë dhe të vrasin vëlla-vëllain.

Mund të na e shpjegoni si e kuptoni ju këtë që është thënë këtu?
PË. Po këtu është thënë që një njeri që kontribuon për vend edhe për fshat edhe me ekzekutuan edhe më të mundu me të njollosë me vepra që nuk i ke pasë është tmerr është. Është krim për së dyti.
PY. Dua të fokusohem te periudha pas vrasjes *[REDAKTUAR]* në *[REDAKTUAR]*.
ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dhe për këtë do i lutesha Sekretares të nxjerri materialin P90, konkretisht faqen *[REDAKTUAR]*. Dhe faqja përkuese është faqja 13 e material PDF, *[REDAKTUAR]*.
PY. Dëshmitar, e njihni këtë artikull që keni përpara?
PË. Po.
PY. E ke lexuar kur është botuar ky *[REDAKTUAR]*?
PË. Po.
PY. Këtë e bëre sepse ishe i interesuar që të kishe informacion lidhur me vrasjen e *[REDAKTUAR]*?
PË. Po, patjetër.
PY. E shihni datën në të djathtë, lart, në krye, thuhet *[REDAKTUAR]*. A është *[REDAKTUAR]* është vrarë *[REDAKTUAR]*?
PË. Është *[REDAKTUAR]* pas vrasjes, se vrasja ka qenë më *[REDAKTUAR]*, kjo është me të *[REDAKTUAR]*.
PY. Thatë që është një *[REDAKTUAR]*. A thuhet në artikull *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. Çfarë thotë?

PË. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*.

PY. Të fokusohemi në artikull. Në të majtë të artikullit, nga gjysma e dytë poshtë, thuhet "*[REDAKTUAR]*". E shihni? "Në bazë të të dhënave *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*", paragrafi 2.

PË. Po, po.

PY. Si e kupton ti, çfarë do të thotë ky "*[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*", kujt i referohet?

PË. Po i referohet arrestimit tyne dhe *[REDAKTUAR]*. Meqenëse s'ka të bëjë asnjë send me këtë shkrim këtu që është shkruar. Kjo është shkru vetëm për ta mbulu krimin që e kanë bë.

PY. E kuptoj. Të fokusohemi tek ajo që është shkruar në artikull, tek teksti i artikullit, tek pjesa ku thuhet po në të majtë pastaj në mes, "*[REDAKTUAR]*". Sipas teje çfarë është ky organ, ky subjekt, kujt i referohet ky?

PË. Po ky *[REDAKTUAR]*, domethënë, si me e spjegu unë. Ka punu me dirigjim dikujna, tinza dikujna edhe nuk di si ta shpjegoj domethënë. *[REDAKTUAR]* ka qenë në atë kohë. Nuk muj as me kuptu unë *[REDAKTUAR]*, kush ka punu *[REDAKTUAR]* aty.

PY. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*?

PË. Po kështu është e shkrune.

PY. Për të folur dhe njëherë për atë që thatë. Ju thatë që akuzon *[REDAKTUAR]* dhe kjo s'është e vërtetë. E kuptova siç duhet?

PË. Po.

PY. Dua të tregoj dhe një artikull tjetër.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] P90. Ndërsa faqja konkrete është *[REDAKTUAR]*. Dhe përkthimi në anglisht është P90.1, faqja 14 në PDF dhe faqja konkrete është *[REDAKTUAR]*.

PY. Dëshmitar, në ekran, domethënë, a e shihni këtë artikull në ekran?

PË. Po, po.

PY. Po ju bëj disa pyetje të ngjashme sikurse bëra me artikullin që pamë para një çasti. E shihni datën që është *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. Njësoj si dhe me artikullin tjetër, a i referohet si
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PË. Po.

PY. A vazhdove të kërkoje informata lidhur me vrasjen e *[REDAKTUAR]* pasi i pe këta artikuj?

PË. Po.

PY. Pse e bërë këtë?
PË. Nuk ndëgjova?
PY. Po, patjetër. Pse vazhdove të kërkoje informacione lidhur me vrasjen *[REDAKTUAR]* edhe pasi i pe këto?
PË. Po këto nuk janë të vërteta ça janë shkru, asnjë. Këto i kanë shkru veç me e njollosë *[REDAKTUAR]*. Edhe i kam taku personat *[REDAKTUAR]* këtu dhe kam bisedu drejtpërdrejt me persona *[REDAKTUAR]*, asnjëni *[REDAKTUAR]* nuk e njeh.
PY. A dëgjove ndonjëherë që UÇK-ja ta kishte shpallur këtë *[REDAKTUAR]* – më falni - a dëgjuat ndonjëherë që UÇK-ja ta kishte denoncuar këtë *[REDAKTUAR]*?
PË. Nuk e ka denoncuar kurrë.
PY. Dhe pasi u raportua kjo, a dëgjove ndonjëherë që UÇK-ja ta mohonte faktin që kishte ekzekutuar *[REDAKTUAR]*?
PË. Jo.
PY. Kalojmë në një fushë tjetër. Më përpara keni thënë se pas ofensivës serbe në korrik 1998, kur anëtarët u kthyen në fshatin tuaj, policia serbe ju afrua *[REDAKTUAR]* për të bërë *[REDAKTUAR]*. A mbani mend ta keni diskutuar këtë gjë?
PË. Po.
PY. Edhe fshati juaj *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* në emër të fshatit dhe *[REDAKTUAR]* ka qenë *[REDAKTUAR]*. A të kujtohet si *[REDAKTUAR]*? A doli *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*?

PË. *[REDAKTUAR]*. Janë kanë përmbi 100 vetë të fshatit, janë kanë edhe ushtria e fshatit edhe *[REDAKTUAR]*.

PY. Me sa di --

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] A mund të na thoni ku e bazon njohurinë e vet, ku e mbështet këtë që thotë?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do ja bëj pyetjen sqaruese.

PY. Nga e dini ju këtë takim?

PË. Po më kanë tregu kur a kthy *[REDAKTUAR]* dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë aty.

PY. E dini nëse ka ndodhur në të vërtetë takimi dhe cili ka qenë rezultati i këtij takimi?

PË. Po. Ka qenë takimi. Rezultati ka qenë: *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

PY. E dini nëse ndonjë nga fshati juaj e miratoi faktin që ky *[REDAKTUAR]*, prefshi dhe *[REDAKTUAR]*, duhet të shkonte në këtë takim?

PË. Po.

PY. E kush ishte ky?

PË. Po ishte udhëheqësia e fshatit, domethënë, fshati ka

përmbi 100 vetë bashkëfshatarë kanë qenë edhe kanë qenë ushtria e fshatit *[REDAKTUAR]*.
PY. A kishte ndonjë me emrin *[REDAKTUAR]* të përfshirë, pra, a kishte ndonjë person që quhej *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* këtë takim?
PË. Po.
PY. Me sa kuptove ti, kush ishte ky person?
PË. Ky ishte ushtar i UÇK-së. Ishte më i vjetri ndër ushtarët e fshatit *[REDAKTUAR]* edhe ai foli në emër të atyre ushtarëve sha kanë qenë aty, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*.
PY. Pasi u krye ky takim, pasi ndodhi ky takim, a pati *[REDAKTUAR]* deri në momentin që filluan bombardimet e NATO-s?
PË. Jo.
PY. Bashkëfshatarët, me sa dini ju, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*? Ishin në favor *[REDAKTUAR]*, ishin kundër *[REDAKTUAR]* apo çdo gjë tjetër, çfarë mendonin?
PË. Bashkëfshatarët ishin *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*.
PY. A e dini nëse *[REDAKTUAR]* ka qenë *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*?
PË. Jo, nuk e di.
PY. Më përpara keni thënë se *[REDAKTUAR]* haptazi e kishte shpallur kur kishte ardhë në fshatin tuaj se do ta vendoste të

gjithë, "*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*" dhe se e bëri këtë shkurtimisht pas ofensivës së parë serbe në verën e 1998. A të kujtohet ta kesh thënë këtë?
PË. Po.
PY. Dhe keni thënë, arsyeja pse e ka thënë ai këtë është se *[REDAKTUAR]* kishte shpëtuar e paprekur dhe nuk ishte djegur asnjë shtëpi, kështu?
PË. Po. Në ofensivën e parë ka pshtu pa u djegë asnjë shtëpi.
PY. *[REDAKTUAR]* ishte i mërzitur për këtë, ishte i zemëruar për këtë gjë?
PË. Nuk e kam pa. Nuk muj ta them. S'di si ta them.
PY. E kuptoj. Dua të kalojmë dhe një fushë tjetër dhe për këtë mund të kalojmë në seancë të hapur, prandaj ju lutem Dëshmitar, kur të flisni mos thoni *[REDAKTUAR]* po thoni i afërmi dhe mos thoni emrin e fshatit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë të hapur.

Prisni një çast.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

ZNJ. MAYER: [Përkthim]
PY. Dëshmitar, a vazhdove të shërbeje në UÇK edhe pas vrasjes së të afërmit tënd?
PË. Po.

PY. Kur kryet detyrat pas vrasjes *[REDAKTUAR]* çfarë vishje?

PË. Pas vrasjes së të afërmit tem, më jam dalë me tesha civile. Nuk kam vesh më uniformë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

PY. E ke akoma uniformën e UÇK-së?

PË. Jo.

PY. Pse s'e ke më?

PË. Po veç m'u patë vjetru dhe u pat shky gati në atë kohë edhe është dëmtu. Tjetër s'kam ble se edhe atë e kam ble, atë tjetër nuk kam marrë tani me ble dhe me civile jam dalë. Edhe nuk kam mujt me veshë atë uniformë kurse e ditën *[REDAKTUAR]* mu vra pi asaj uniformës. E kam pak problem atë formën me hi në shtëpi prapë, në familje.

PY. E kuptoj.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] A mund të kalojmë një çast në seancë private ju lutem.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]. Kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F1654*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Kemi dy referenca, këtu përmendet *[REDAKTUAR]* dhe është thënë dhe *[REDAKTUAR]* në seancë të hapur. Mbase do ishte me vend që të bëni një redaktim për këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, që na e vutë në dukje, kemi mundësinë që të redaktojmë. Po. Faleminderit.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Pajtohemi. Jemi vigjilentë dhe ne po vërtetë e vlerësojmë që znj. O'Reilly e vuri në dukje.

Kaq pyetje kisha unë, kështu që mund të kalojmë në seancë publike ose mund të qëndrojmë në seancë private nëse Mbrojtja do të fillojë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Moskowitz, doni të jetë në seancë publike apo private?

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Mund të përpiqemi në seancë të hapur dhe kur të arrij në atë pikë që mendoj që është me vend të kalojmë në seancë të mbyllur do ta bëj me dije Trupin Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Atëherë le të kalojmë në seancë publike.

Znj. Mayer, s’ka ngelur diçka tjetër për të thënë?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk e di nëse duhet ta bëja me dije në seancë publike që e mbarova pjesën time të pyetjeve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo. Nuk ka nevojë.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Moskowitz, mund të vazhdoni.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga të palës tjetër nga z. Moskowitz:

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim]

PY. Dëshmitar. Përshëndetje. Mirëmëngjes. Unë quhem Albert Moskowitz dhe jam një nga avokatët që përfaqësojnë z. Thaçin. Do t'ju bëj disa pyetje. Ju lutem, në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen që ju bëj, lirisht më thoni t'ju a shpjegoj dhe unë me shumë kënaqësi do ta bëj këtë gjë. E kupton këtë?

PË. Po.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë për ndërprerjen, a ka ndonjë gjë në listën e prezantimeve sepse në Legal Workflow nuk është hedhur asgjë.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Jemi duke e bërë tani ose e kemi nxjerrë në radhën e prezantimeve. Po e bëjmë tani. Në rregull.

PY. Dëshmitar, do të doja të filloja me faktin me bashkëngjitjen me kyçjen tuaj në UÇK. Nëse e kam kuptuar siç duhet, ju thatë që u bashkëngjitët më 24 korrik 1998 në UÇK, kështu?

PË. Po.

PY. Më duket, se ju përshkruat procesin si ju bashkëngjitët, që në thelb, siç e kuptova, unë ishte kështu, erdhi dikush tek ti dhe të tha na duhen përforcime në një fshat tjetër dhe ti shkove për të marrë pjesë në mbrojtjen e këtij fshati kundër forcave serbe. E kam kuptuar saktë?

PË. Po. Edhe është ardhë me emën, jo një person, po ka emën

personi.

PY. Po. Mund ta diskutojmë emrin më vonë, po nuk është nevoja që emrin ta themi tani.

Kur u bashkëngjite UÇK-së atë datë, atë mbrëmje, nënshkrove ndonjë gjë që të vërtetoje diku që tani ishe anëtar i UÇK-së?

PË. Jo.

PY. A more ndonjë letërnjoftim a ndonjë copë letër ku të thuhej që ti tani ishe anëtar i UÇK-së?

PË. Unë jam dalë në ora 2.00 të natës atë natë, kurse të nesrit i kanë marrë shënimet komandanti kush ka qenë aty.

PY. Morën shënime. Po nuk të dhanë ndonjë kartelë a letërnjoftim, na një copë letër, ku thuhej dhe verifikohej se, në fakt, në të vërtetë ishe anëtar i UÇK-së? Mos më keqkuptoni, nuk e vë në dyshim që keni qenë anëtar i UÇK-së. Thjesht po përpiqem të kuptoj a ka pasur ndonjë gjë që e vërtetonte dhe ti mund t'ua tregoje personave që unë tani jam anëtar i UÇK-së?

PË. Jo, nuk më kanë dhënë.

PY. Po uniformë të dhanë, të dhanë ndonjë uniformë në atëkohë?

PË. Uniformën e kishna ble vetë. S'ka pasë në atë kohë është duht me ble edhe me si ceratë kena ble, të kamuflazh dhe i kena pagu me bë vesh ushtarake domethënë.

PY. Pra, nuk të dhanë para për ta blerë uniformën e ke blerë

vetë, kështu?
PË. Po.
PY. Uniforma ishte e gatshme kur e bleve apo bleve copën edhe e qepe?
PË. Në atëkohë blejshim copa dhe i qepshim.
PY. Po nga e dije se çfarë cope të blije? Kishte ndonjë rregullore që të tregonte se çfarë cope duhet të blije në verën e 1998?
PË. Po ishin copa kamuflazhi, taman të ushtries si cerada, ato i kena ble dhe ato i kena kepë.
PY. Kur ju bashkëngjite UÇK-së të dhanë armë?
PË. Armën e kisha marrë nga një bashkëfshatar.
PË. Në rregull. Nuk kemi nevojë të përmendim emra. Pa e përmendur emrin e këtij bashkëfshatarit, si ndodhi që ky bashkëfshatari të dha armën e tij? Po ai vetë nuk ishte në ushtri në atë kohë?
PË. Po ish lodhë. Ish mërzit, ku ta di unë. Edhe më tha "Kush kërkon për me dalë muj me ja dhënë" dhe e kam marrë.
PY. Ti thua "ishte lodhë". Do të thotë që nuk donte të vazhdonte më, ishte lodhë me ushtrinë. Këtë do të thuash?
PË. Nuk muj me thanë kurrgjë. Meqenëse ai prapë është kyç ma vonë. Nuk muj me thanë kurrgjë.
PY. Po. Pra, ky personi ndonjëherë shkonte është kyç, ndonjëherë nuk është kyç varej si mbas qejfit të vetë domethënë?

PË. Nuk e di.

PY. Në rregull. Në rregull. Meqë ra fjala ti na the që e bleve copën dhe e qepët uniformën. Këtë gjë nuk e bënte -- mund ta bënte kushdo edhe një njeri që s'ishte në UÇK, çdonjëri mund të blinte copën mund të bënte një uniformë edhe pa qenë në UÇK? Ishte e mundur kjo gjë?

PË. Po, nuk e bën në rast se nuk ke pasë armë ti edhe me dalë me ju bashkëngjit ushtries, ti nuk ke pasë nevojë as me e ble, as me e bë. Nuk muj me thanë për kërrkund kurrgjë, unë po flas personalisht për vete si ka ndodhë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Moskowitz, kur mbaron pyetjen, kur mbaroni pyetjen fikeni mikrofonin.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Më falni. Tani është në rregull se do bëj pyetjen.

PY. E kuptoj, ti di atë që ke bërë vetë, por duke pasur parasysh faktin që atyre që kyçeshin në UÇK nuk u jepej ndonjë dokument, kjo tregon se çdo njeri po të donte mund të blinte copën të bënte uniformën edhe pa qenë në UÇK? Sepse gjërat ishit kështu jo zyrtare si të thuash?

PË. Nuk besoj që dikush ka ble uniformë pa qenë i kyçur.

PY. Në rregull. Kur u kyçe në UÇK, a bëre ndonjë trajnim përpara se të shkoje në betejë pra?

PË. Ishna i pregatitun pak ma herët.

PY. Ça do të thuash që ishte "i përgatit"? A mund të na e shpjegosh?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PË. Përdorimin e armës.
PY. Përveç përdorimit të armës, ndonjë gjë tjetër?
PË. Jo.
PY. Ti ke dëshmuar më herët se ke shkuar në një fshat tjetër për të marrë pjesë në aksion kundër forcave serbe, a ka qenë kështu?
PË. Po, se aty ishte prita, mbrojtja e fshatrave mbrapa.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Mbase duhet të shkojmë në seancë të mbyllur për pak kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në seancë të mbyllur për të mbrojtur dëshmitarin. Më falni, private, jo seancë të mbyllur po private.

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F1654*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z. Moskowitz.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Të shohim tani në ekran DHT00577. Është një hartë. A mundet nga ana teknike ta zmadhojmë një çik këtë hartën duke pasur parasysh si pikë qendrore *[REDAKTUAR]*. Aty shumë mirë.

PY. Z. Dëshmitar, e shikon këtë hartën. E sheh në ekran aty përpara?
PË. Po.
PY. Në rregull. Unë kam rrethuar aty dy fshatra me të kuqe. I shikon?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PË. Po.

PY. Një nga fshatrat është *[REDAKTUAR]*.

PË. Po.

PY. Po të shikosh përgjatë kësaj rruge, është ajo vija që lidh *[REDAKTUAR]* me *[REDAKTUAR]* aty nga fundi i hartës. Ka një kuadrat ke *[REDAKTUAR]*, e shikon, është i bërë një kuadrat me blu?

PË. Po.

PY. Dhe tek ky fshat shkove ti për të luftuar për vendin tënd kur u kyçe në UÇK, në fshatin *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. A mund të na shpjegosh që, ta kuptojmë më mirë atë që ndodhte atëhere, sesi forcat serbe erdhën në *[REDAKTUAR]* dhe ju luftuan ë krahët -- e sulmuan nga krahët UÇK-në? A mund të na i shpjegosh dot?

PË. Forcat serbe kanë qenë në *[REDAKTUAR]*.

PY. Ishin në *[REDAKTUAR]*. E di sesi arritën nga arritën, nga ça rruge ndoqën? Nga *[REDAKTUAR]* erdhën aty apo nga erdhën?

PË. Jo. Këta janë kanë kohë ma herët, para se me dal unë, janë kanë të pozicionum në fshatin *[REDAKTUAR]*, në qendër *[REDAKTUAR]*.

PY. Pra, ti nuk e di sesi arritën sepse ti shkove mbasi ata ishin aty?

PË. Po.

PY. Forcat serbe ishin vetëm ushtarë me armë apo kishin mjete të mekanizuara të mëdha?

PË. Jo, kishin edhe mjete me mekanizma.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PY. Kishin dhe tanke?

PË. Mund të kesh pasë, po nuk e kam pa.

PY. Në rregull. Ti the që shkove në *[REDAKTUAR]* për disa ditë për të mbrojtur vendin por pësuat disfatë, kështu është?

PË. Po.

PY. Sepse forcat serbe ishin shumë të fuqishme, kështu?

PË. Forcat serbe kishin thy pikën tjetër nga ana tjetër. Edhe e kishin thy të gjithë *[REDAKTUAR]* dhe janë kanë tuj ardhë, domethënë, me ju bashkangjit prej *[REDAKTUAR]* me ardhë *[REDAKTUAR]*. Me na zënë pi mbrapa janë kanë tuj ardhun. Atëhere na erdh lajmi me u tërhek na, me e lëshu ne këtë pikë, se prej të dy anëve deshëm me na zënë të gjallë aty. Edhe jena tërhek me urdhën të komandantit.

PY. A të kujtohet se ku shkut kur u tërhoqët? Një minutë. Përpara se t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Thatë që u tërhoqët. Ju kujtohet sesi ju tha, çfarë urdhri ju dha komandanti? Çfarë ju tha që të tërhiqeshit, nëse ju kujtohet?

PË. Komandanti në atë kohë nuk e pashë, mirëpo ushtarët çka ishim aty, një prej ushtarëve ai më i vjetër, na lajmëroi, tha që "Komandanti po thotë me u tërhek, se e kanë thy pikën e *[REDAKTUAR]* dhe janë tuj ardhë në drejtim të *[REDAKTUAR]*".

PY. Ju tregoj se ku të shkonit mbas tërheqjes?

PË. Jo.

PY. Pra, ju shkuat aty ku menduat se do të ishit më të sigurtë, kështu?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PË. Po.

PY. Dhe shkuat edhe me të tjerë apo vetëm?

PË. Jo, me të tjerë.

PY. Pastaj shkuat në fillim në një fshat të quajtur *[REDAKTUAR]*? E shikon në hartë. *[REDAKTUAR]* është e rrethu me një kuadrat jo larg nga *[REDAKTUAR]*, po të kalosh nga ana e majtë.

PË. Po.

PY. Pse shkuat aty?

PË. Po ishte e largume prej asfaltit kryesorë edhe ishke e kishke malin para dhe aty nisën me tubu ushtarët dhe aty ish kanë komandanti kur shkum.

PY. Dhe kur thua që ishte larg nga rruga kryesore, e ke fjalën për rrugën që lidh *[REDAKTUAR]*, për këtë rrugë?

PË. Po.

PY. Pra, kjo ishte rruga që serbët ndiqnin për të sulmuar fshatrat e asaj zone, kështu ka qenë?

PË. Po.

PY. Sidomos po të kishin dhe forcat e mekanizuara, ju duhet të kishin një rrugë të fortë, një rrugë të shtruar, për të ecur përpara, kështu?

PË. Si po mendon rrugë të fortë, të shtruar?

PY. E kam fjalën për rrugë me asfalt që të përdorej nga mjetet e mekanizuara, rrugë asfalti.

PË. Po ne nuk kishin mjete të mëdhaja në atë kohë. Na kishin

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

ndonjë armë nji, me shpinë çka kemi mujt me çu. Nuk kishim tehnikë që me thanë që po hyjnë anej ose nuk po del knej. Nuk kishim asnjë send të madh.

PY. E di. E kisha fjalën për serbët. Ata kishin?

PË. Ata kishim. Po.

PY. Prandaj juve ju desh të largoheshit nga rruga kryesore sa më shumë që të mundeshit për të qenë të sigurtë dhe shkuat në *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. Sa kohë ndenjët në *[REDAKTUAR]*? Një ditë, një mbrëmje, një natë?

PË. Jo, kena ndenj deri në mbrëmje. Në mbrëmje jam shku jam taku me familjen në fshatin *[REDAKTUAR]* i kam pasë.

PY. Familja ishin ndërkohë në *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. *[REDAKTUAR]* e shohim këtu në hartë. Kështu që e kuptojmë, orientohemi.

Pastaj bashkë me familjen u ktheve në *[REDAKTUAR]*, mbas disa ditësh apo javësh që arritët më në fund të ktheheshit?

PË. Saktë nuk e di. Ndoshta java ka qenë. Me datë nuk e di.

PY. Në atë kohë, a e kishit të qartë se në cilën njësi bënit pjesë mbasi u mundët aty, mbasi u tërhoqët nga *[REDAKTUAR]*? A e dije ti se në ç’njësi bëje pjesë në atë kohë apo ishte e paqartë?

PË. Ishte e paqartë.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PY. Pse ishte e paqartë?

PË. Po ku ta di unë. Tani i kanë pej *[REDAKTUAR]* që është thirr *[REDAKTUAR]* i kanë qit në *[REDAKTUAR]* dhe s'jam marrë unë me ato. I kanë pasë tjetërkush a marrë dhe unë s'jam marrë me këtë punë hiç. As nuk e di s'i ka shku ajo.

PY. Pra, nuk kishte njeri në postin e komandantit të thoshte se ty e ke vendin këtu. Ti kërkoje të ishe i sigurtë vetë?

PË. Jo. Na u tubum atë kohë të gjithë në fshat dhe të bëjshim roje në fshat tani. Pej kur janë formu këto brigada, këto sene.

PY. Kur thua "në fshat" e ke fjalën për *[REDAKTUAR]* apo mbasi je kthy në *[REDAKTUAR]*?

PË. Pasi jam kthy në *[REDAKTUAR]*?.

PY. Mbasi? Pra, kur ishe në *[REDAKTUAR]* nuk ke qenë në ndonjë njësi. Thjesht ke kërku të jesh i sigurtë vetë, të bësh si të mundësh, të bëje si të mundje për të qenë i sigurtë, për t'u mbrojtur si të thuash?

PË. Jo. Të gjithë ushtarët dolëm atje dhe na tregun që për momentin nuk ka, "nuk muj me ju bë zgjidhje, gjindna si të mundni" na tha komandanti. Edhe s'kishim ça të thojmë, ishna me familje tashti. Ishim të gjithë, ishim shku napër familjet tona. Rrijshim me familjet tona.

PY. Pra, komandanti ju tha: Bëni atë që mendoni për të shpëtuar veten, pak a shumë, kujdesuni për veten. Do ishte e saktë ta thonim kështu?

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

PË. Po, përafërsisht.
PY. Po, përafërsisht. Kur u ktheve në fshatin tënd *[REDAKTUAR]* ti ke dëshmuar se vazhdove të qëndroje në UÇK dhe të veproje si roje fshatit, pa e ditur se në çfarë njësie e kishe vendin, kështu?
PË. Po.
PY. Kur je kthyer në *[REDAKTUAR]*, ke qenë i veshur me uniformë apo vendose të vishje teshat civile apo ca ditë vijshe uniformë, ca ditë vishje teshat civile?
PË. Jo, me uniformë.
PY. Pra, çdo ditë ke qenë me uniformë, kështu?
PË. Po.
PY. Po ushtarët e tjerë që u kthyen në *[REDAKTUAR]*, po ata tjerët, gjatë gjithë kohës ishin të veshur me uniformë apo ndonjëherë edhe me teshat civile?
PË. Shumicën e rasteve me uniformë kanë qenë kush ka dalë në roje aty.
PY. Dua që t'jua freskojë kujtesën për diçka.
Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Prandaj do të ishte mirë të paraqisnim në ekran SPOE006832-SPOE0068043, që është përkthimi në anglisht dhe shqip po ashtu. Ka të njëjtën numër. Dhe duhet të shohim faqen SPOE00068039.
PY. Po. Të lutem, shiko -- një minutë, sa t'ju kujtoj, kjo është *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

*[REDAKTUAR]*. Mbase të kujtohet. Dhe nuk ka numra, për fat të keq, për këto rreshtat. Por shiko aty ku thotë:

"Kur u kthyet në fshatin *[REDAKTUAR]* nga *[REDAKTUAR]*... a pe ndonjë ushtar të UÇK-së?"

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

PË. Mvaret në çfarë konteksti e bëni pyetjen. Kur jena kthy në fillim kanë qenë me uniformë. Tashti mvaret dhe në çfarë konteksti më ka pyetje ai, atje. Nuk muj me e lidhë unë pyetjen tënde me pyetjen e atina.

PY. Por në një moment, pra, në një kohë ishin të veshur me tesha civile. A të kujtohet kur filluan që t'i hiqnin uniformat dhe të vishnin tesha civile?

PË. Uniformën e veshin veç kur kishkin ndoshta me dalë në pikë, se ai non-stop s'ka nejt në uniformë, se janë kanë fshatarë. Uniformën e kanë pasë në shtëpi. Kur janë shku në

shtëpi janë shku civilë, ai ka veshë teshat e civile. Kur a dalë aty ka dalë dikush kanë dalë me uniformë. Po ka pasë edhe ndonjë që ka dalë me civile. Tashti nuk e ka pa rregulla se dile vishe uniformën ose mos e vish.

PY. E kuptoj. Pra, nuk kishte ndonjë rregull të rreptë, pak a shumë, secili bënte si të donte, nuk kishte ndonjë komandant në fshat.

PË. E kishim një komandant në fshat aty.

PY. Kush ishte ai?

PË. Ai në atë kohë u bë *[REDAKTUAR]*.

PY. Faleminderit. Ta përmbledhim pak këtë pak këtë pjesë të historisë. Pajtohesh me mua se në këtë kohë që po flasim, këtë kohën që ke qenë në *[REDAKTUAR]* që ikët andej mbas sulmit të forcave serbe dhe shkuat për të qenë i sigurtë larg, te ai fshati larg nga rruga kryesore, pastaj u kthyet në *[REDAKTUAR]* dhe aty ndejtët, pak a shumë, deri sa filluan bombardimet e NATO-s në prill të 1998. Kështu është? Kam drejtë që mendoj kështu?

PË. Po aty kena ndejtë.

PY. Gjatë gjithë kësaj periudhe ke qenë në fshat si roje fshatit në kuadër të UÇK-së?

PË. Jo, kam dalë edhe jashtë fshatit.

PY. Oh.

PË. Saktë tashti, nuk muj me ditë saktë. Nuk kam dalë në atë kohë, domethënë, për me shku për me bë një aksion, po kam mujt

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

me dalë edhe ndonjë kund. Tash nuk muj me të tregu saktë a kam nejt non-stop aty.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të bëjmë një pushim të shkurtër.

Kalojmë në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shoqërojeni dëshmitarin të dali nga salla për momentin, ju lutem.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë një pushim të shkurtër rreth pesë apo dhjetë minutash dhe do të kthehemi përsëri.

--- Pauza fillon në orën 10.27

--- Seanca rifillon në orën 10.34

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të sillni dëshmitarin.

Dëshironi të vazhdoni në seancë private apo publike?

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Do të përpiqem që sa të mundemi të jemi në seancë të hapur, por unë dua të flas tani për ca hollësi të ngjarjes. Dhe mendoj se duhet të përpiqemi që të shmangim emrat, po në të njëjtën kohë ta kuptojmë se për çfarë po flasim.

*[REDAKTUAR]*

jemi në seancë të mbyllur? Jemi në seancë të hapur.

Duhet të kalojmë në seancë të mbyllur atëherë që ta diskutojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F1654*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] E kuptojmë shqetësimin që ka Trupi Gjykues që kjo seancë duhet të jetë sa më shumë e hapur dhe unë do përpiqem ta bëj këtë, por kjo kërkon që të kemi një mirëkuptim, të kuptojmë njëherë si do t'u drejtohemi personave.

Do t'i kërkoj dëshmitarit që të më përshkruajë me hollësi se çfarë ndodhi në fshat gjatë kidnapimit, që nga momenti që del nga banesa, çfarë pa, ku ishte dhe deri në momentin që u largua nga fshati.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'ju propozoj ta sjellim dëshmitarin në seancë private, të identifikojmë pjesët që doni të identifikoni dhe t'u jepni një numër, duhet t'i jepni një copë letër me shkrim që ta ketë parasysh edhe mos të ngatërrohet me emrat dhe me numrat pastaj pra, për çdo gjë që doni të diskutoni jepini një numër, përfshi dhe emrin e fshatit këtu.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Unë normalisht do t'i mbështesja të tilla propozime. Ajo që është pak e vështirë në këtë rast është kjo, ky *[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

Unë e vlerësoj Mbrojtjen që përpiqet dhe e ndan shqetësimin tonë sa më shumë të hyjmë në hollësi, *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] E vlerësoj shqetësimin. Është e vështirë të ndajmë fijen e perit këtu, të gjejmë atë të mesmen e artë. Unë nuk dua ta them emrin e fshatit. Unë do them "fshati". Mund t'i japim numra, mund të caktojmë numra të afërmve.

Po dy pikat ku do hyjë më në thellësi do të jetë *[REDAKTUAR]*, po *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* në fund të rrugës së fshatit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që Prokuroria, mendoj unë, që Prokurorja vlerëson se çdo gjë që themi ne do të jetë identifikuese, do të shërbejë për të

identifikuar.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] A mund të bëj dhe një propozim?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

[Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të përpiqemi në seancë publike. Do përpiqemi të jemi të kujdesshëm. Jepini këshilla dhe udhëzoheni. Ndërsa për këto vendet që thatë mund të themi Pozicioni 1, Pozicioni 2, t'u japim ndonjë kod. Duhet ta përgatisë dikush në letër për të që dhe dëshmitari ta dijë kujt i përkon kodi për cilin kod po flet.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Po. Na jep një çast atëherë që ta përgatisim këtë material.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokurore, më fal se ju ndërpreva, kishit diçka për të thënë?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, unë ju kërkoj ndjesë se unë ju ndërpreva ju. Unë thjesht do të propozoja, siç thatë në urdhrin tuaj për masat mbrojtëse, një mënyrë tjetër për ta bërë këtë do ishte të shihnim me kujdes transkriptin më vonë për të fshirë çdo gjë që mund t'i dali publikut.

Ju e patë, që edhe unë pse isha e kujdesshme, kur po u bëja pyetje dëshmitarit m'u desh ta riformuloja gjashtë herë pyetjen që të merrja përgjigjen dhe mos t'i nxjerrja informacione të tjera dhe prapë kemi pasur dhjetë kërkesa për

redaktime.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo është gjë shumë e rëndësishme. Kjo është pjesë shumë e rëndësishme në këtë çështje gjyqësore, duhet të kemi sa më shumë parasysh faktin që seancat duhet t'i kemi publike. Nuk po argumentoj atë që po thoni ju, po duhet të përpiqemi ta trajtojmë.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Na nevojiten pak çaste për ta përgatitur dhe ai lexon vetëm shqip, kështu që mbase do të duhet t'i shkruajë vetë ai në shqip kodet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem. Thoni kur të jeni gati.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Ne propozojmë këtë. Dhe të shoh nëse pajtohet dhe Prokurorja. Nuk është shumë e komplikuar, shumë e koklavitur. *[REDAKTUAR]* i tij, *[REDAKTUAR]*, do të marrë numrin 1; *[REDAKTUAR]*, numrin 2; dhe, *[REDAKTUAR]*, me numër 3. Jeni dakord me këtë?

Ndërsa për pikat e referimit që besoj se do t'i diskutojmë, *[REDAKTUAR]*, do të themi pozicioni A, me që është pika e parë e referimit në histori; dhe *[REDAKTUAR]* që janë në fund të fshatit dhe me këtë mbyllet dhe historia ose më falni, më saktë është pjesë e historisë të themi pozicioni B.

Po ia shtroj edhe Prokurorisë këtë në qoftë se pajtohen. Dhe, nëse pajtohen, mund ta thërrasim në seancë të mbyllur dëshmitarin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po edhe

rrugët, drejtimet, se ai shkon në një fshat tjetër, mbase dhe këtë duhet ta keni parasysh.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Po. Në këtë pjesë, në këto pyetje që do bëj tani do fokusohem vetëm te fshati i *[REDAKTUAR]*, para se të dali në rrugë, sepse dua të marrë disa sqarime ku ishte, sa larg ishte, çka pa.

Edhe këto janë pyetjet sepse s'jam shumë i qartë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë të pamundurën atëherë.

Znj. Prokurore, besojmë se dhe zyra juaj më pas do të rishikojë transkriptin për të parë nëse ka nevojë për të bërë redaktime të tjera dhe të bëjë me dije avokatët dhe Trupin Gjykues.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dakord. Nuk kemi asnjë kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Tani mund të sjellim dëshmitarin.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Sa t'ia shpjegojmë këtë gjykoj që të qëndrojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk i themi e mbyllur, i themi private.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, jemi në seancë të mbyllur tani. Që do të thotë askush kësaj

salle nuk dëgjon ato që po thoni ju, po për një çast të kalojmë në seancë të hapur, seancë publike, për pjesën e mbetur të pyetjeve.

Z. Moskowitz do të shpjegojë se çfarë do bëjmë që të mbrojmë ju personalisht dhe bashkëfshatarët apo personat e tjerë në fshatin tuaj. E kuptoni këtë?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z. Moskowitz.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.

PY. Z. *[REDAKTUAR]*, tani do të flasim për një fushë të pyetjeve që lidhen me fshatin tuaj dhe me ditën e kidnapimit *[REDAKTUAR]* tuaj dhe për këtë duhet të diskutojmë disa detaje, po ne duam ta bëjmë në seancë të hapur këtë gjë, por nuk duhet të nxjerrim identitetin tënd. E kupton këtë? Deri tani. Nuk kam mbaruar.

Tani për ta bërë këtë, nuk duhet të përdorim asnjë emër, por emrave do t'u japim numra dhe çdo numër përfaqëson një emër. Për shembull, nëse duhet të flasim për *[REDAKTUAR]*, nuk do themi *[REDAKTUAR]*, ti nuk do thuash *[REDAKTUAR]*, po do thuash numrin që i kemi vendosur ne *[REDAKTUAR]*. Tre persona kemi që cilëve duhet t'u japim numra: Është *[REDAKTUAR]*, 1 do themi *[REDAKTUAR]* numër 1; *[REDAKTUAR]*, numër 2; edhe *[REDAKTUAR]*, numër 3. 1, 2 dhe 3. Do të japim dhe një copë letre që t'i kesh përpara këto që të mos i harrosh.

Gjithashtu, në këtë pjesë të pyetjeve do flasim për dy pika referimi në *[REDAKTUAR]* që ti i njeh shumë mirë. Një është *[REDAKTUAR]* do ti themi A. Dhe *[REDAKTUAR]*, që janë në fund të fshatit dhe *[REDAKTUAR]* do t'u drejtohemi me B.

Këto janë shumë mbase për t'i mbajtur mend. Shumë gjëra ke sigurisht që duhet të mbash mend dhe po shtojmë dhe gjëra të tjera që do të duhet të kujtosh. Po duam të përpiqemi që ta kemi sa më të hapur këtë gjykim.

Do t'ju japim një letër, një fletë që i ka të shënuara këto që sapo të thashë që të shohësh. Fatkeqësisht, nuk dimë të shkruajmë në shqip, mbase ne mund të japim një letër dhe ta shkruash vetë në shqip ose të shënosh vetë në shqip që të kuptosh se kujt i referohet secili numër që të mos ngatërrohesh.

A jeni dakord me këtë?

PË. Po. I shkruaj vetë.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Atëherë, ne do t'i japim këtë letrën.

Duhet t'ia jepni dëshmitarit.

PY. Shoh që po shkruani, që është shenjë e mirë. Lart është emri *[REDAKTUAR]*, numër 1.

PË. Po.

PY. Poshtë *[REDAKTUAR]*, numër 2.

PË. Po.

PY. Poshtë *[REDAKTUAR]*, numër 3.

PË. Po.

PY. *[REDAKTUAR]*, pozicioni A. E kuptove.

PË. *[REDAKTUAR]*, okei.

PY. Pozicioni A. E kuptove. Nuk është se kërkon ndonjë teknologji të lartë, po duhet mjaft që të funksionojë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe dhjetë minuta kanë ngelur për këtë seancë, po është përpjekje e mirë të shohim si do të dali.

Vazhdoni, z. Moskowitz.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Tani dua që të fokusohesh tek ajo ditë e tmerrshme më *[REDAKTUAR]*.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më fal, jemi akoma në seancë private.

Kalojmë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Tani mund të vazhdoni.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, duam që tani të fokusohesh, nëse mundesh, tek *[REDAKTUAR]* dhe dua, me sa të kesh mundësi, të më japësh një vlerësim kohor. Dua të më thoni sa kohë ka kaluar nga momenti që u largove nga shtëpia se dëgjove krisma dhe deri në momentin që u largove nga fshati. Pra, dëgjove krisma,

del nga shtëpia dhe deri në momentin që u largove nga fshati në pozicionin B, sa kohë kaloi.

PË. Aty ka kalu përafërsisht krejt dhjetë minuta.

PY. A mund të ketë qenë më pak se dhjetë minuta më shumë se dhjetë minuta, apo kaq të kujtohet tani?

PË. Kaq përafërsisht më kujtohet, nuk muj me tregu me minuta saktë.

PY. Besoj se gjatë kësaj periudhe kohore, këtij dhjetë minutëshit, po themi, ndodhën shumë gjëra, apo jo? Ishte goxha e tensionuar situata, lëvizje shumë të shpejta, kaos. Pajtohesh me mua?

PË. Po.

PY. Dhe krisma, kështu?

PË. Po.

PY. Njerëz flisnin me zë të lartë. Tubime, kështu?

PË. Po.

PY. Ti sa kishe dalë nga shtëpi dhe po përpiqeshe që të kuptoje çka po ndodhte, kështu?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Moskowitz, kujtoni të mbyllni mikrofonin kur mbaroni pyetjen.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim]

PY. Pra, ishte ditë e vështirë ajo ditë për ju?

PË. Po.

PY. Mendoj se kur ke dhënë dëshmi sot paradite, kur dhe dëshmi sot paradite, the se kur pe për herë të parë, kur pe

për herë të parë rrëmbyesit, kidnapuesit, mbase ishe 150, 200 metra larg, kështu?

PË. Po.

PY. Dhe në atë moment, ku ishe ti, ishe afër shtëpisë apo ishe diku tjetër kur i pe ata 150, 200 metra larg, ti vetë në ç'vend ishe?

PË. Po unë u nisa me shku në drejtim tyne. Njëherë veç krismat i kam ndëgju dhe jam nisë me dal.

PY. Pra dhe në atë pikë këta ishin 150, 200 metra larg, kështu?

PË. Po.

PY. Besoj se the që pas kësaj i rashë trup, kështu?

PË. Po.

PY. Sa zgjati kjo rruga shkurt trup?

PË. Po mund të zgjatë 2 minuta 3. Nuk e ka këqyrë orën.

PY. Pra, del nga shtëpi, dëgjon krisma, situata kaotike e paqartë dhe i bie trup dhe kjo rrugë trup zgjatë 2, 3 minuta. Është e drejtë të themi kështu?

PË. Përafërsisht.

PY. Gjatë kohës që ishe në këtë rrugë, a pate mundësi të shihje kidnapuesit, kur ishe në trup, i pe kidnapuesit?

PË. Po. U takova me kidnapuesit.

PY. Pyetjen e kam konkretisht tek kjo rruga shkurt që po përshkruan. Në këtë rrugën kur ishe, gjatë kohës që po bëje këtë rrugën shkurt, i pe? A mund të na i përshkruash pak,

sepse e kam shumë të vështirë ta vizualizoj, ta imagjinoj. A mund të na e përshkruash pak ç'ishte kjo rruga trup?

PË. Po ish një rrugë trup që del në rrugën kryesore. Pej ajo rruga trup ishke shumë afër se pi *[REDAKTUAR]* 150 metra përafërsisht ka qenë A, këtu trup ku jam dalë unë as 70, 80 metra nuk i ka.

PY. Po ashtu dje thatë se dëgjuat të bërtitma në një moment nga disa njerëz që ishin të tubuar diku dhe për shkak të këtyre britmave ti e dije, e kuptove se të afërmit ishin një kerr dhe i kishin marrë persona me maska. A mund të na e shpjegoni ku ishe kur i dëgjove këto britma?

PË. Tuj dalë me te krismat. Tuj dalë, domethënë, me shku te A aty gjindja më tregun që kanë hypun i kanë marrë këta tre dhe është nis kerri te poshtë.

PY. Pra, ti e kuptove çfarë po u ndodhte të afërmve për shkak të asaj që thanë njerëzit, jo se e pe vetë, kështu?

PË. Vetë nuk e kam pa ka kanë hyp, por kur rrugës trup kur jam dalë i kam pa të hypur. I kam pa në kerr.

PY. Pe 1, 2 dhe 3 në kerr apo pe vetëm 1 dhe 2 apo 1 dhe 3?

PË. E kam pa 1 dhe 2. 3 nuk e kam pa. Po edhe ai ish kanë brenda, po s'e kam pa se kerri më kalu.

PY. Pra, 3 nuk e pe në kerr në ato moment?

PË. Si the dhe njëherë? Edhe njëherë pyetjen?

PY. Pra, pyetja ishte kjo, dje the se dëgjove njerëz në një turmë tubim dhe të thanë që të afërmit ishin në një kerr me

kidnapuesit me njerëz me maska dhe për shkak të kësaj -- më falni sa të gjej dhe referencën e saktë dhe për shkak të kësaj, unë citoj, ti the "unë e kuptova që të afërmit i kishin marrë në një kerr persona me maska".

Pyetja ime ishte kjo, ti këtë e more vesh se e dëgjove nga personat që ishit aty të tubum, jo se ti i pe ma sytë e tu. Është e drejtë ta themi kështu?

PË. Ata më tregun që i kanë marrë, me sytë e mi i kam pa 1 edhe 2 kerri ka ka shku te poshtë. Në kerr. Këta dy i kam pa në kerr.

PY. Në atë moment, kerri po shkonte në drejtim të pozicionit B, është e saktë të themi kështu?

PË. Po.

PY. Dhe në atë moment u afrove kerrit, ishe më afër kerrit? Kështu thatë dje, me sa kujton?

PË. Ishna pak më afër kerrit. Po nuk kam lanë ata me maska me ju afru në rrejtë. Dy me maska që kishin aty nuk më lejun me u afru. Shkojshin mbrapa kerrit. Kerri ecke dhe ata mbrapa kerrit dhe më drejtoj armën "Nuk ke nevojë me u afru ma afër".

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj se është koha e përshtatshme për pushimin, më thoni. Po në qoftë se keni dhe një, dy pyetje mund t'i mbarojmë.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

PY. Pra, personat që po ecnin apo pas kerrit nuk të lanë t'i afroheshe kerrit, kështu që ti pe vetëm 1 dhe 2 dhe jo 3 në

makinë. Dhe kjo ishte afër pozicionit B, kështu?
PË. Para se me shku te pozicioni B. Se pozicioni B ishke ma poshtë. Nga kjo rruga ka kam shku unë pozicioni B është ma poshtë.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta redaktojmë.
Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.
PY. Një pyetje tjetër. A e pe 1, 2 dhe 3 të dilnin nga kerri në pozicionin B?
PË. Jo.
PY. Ku ishe kur dolën nga kerri në pozicionin B nuk ishe vetë atje?
PË. Jo, unë u ktheva ku nuk më lanë me u afru nga të kerrit, unë u ktheva e mora kerrin tem dhe armën në shtëpi dhe jam nis me i ndjek mbrapa. Edhe kur kam shku te rruga B, i kam pa të zbritun 2 edhe 3. I kishin zbrit pi kerrit.
PY. Që ta përmbledhim shkurtimisht. U ktheve në shtëpi që të merrje kerrin dhe armën, përpara dhe këtë e bëre, domethënë, përpara se të shihje 1 dhe 2 dhe 3 të dilnin nga kerri. I pe jashtë kerrit kur u ktheve me kerrin tënd atje.
A mund ta themi kështu?
PË. Kur u ktheva me kerrin tem vetëm 2 dhe 3 kanë qenë jashtë.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndaloni një çast, Dëshmitar.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Besoj që tha 1, 2 dhe 3 kolegu im. Nuk ka thënë gjë në dëshminë e vet që 1 ka dalë nga kerri.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] E bëra gabim pyetjet. Do ta bëj dhe njëherë po në mënyrë të saktë tani.

PY. Të jemi pak më të saktë, nuk është faji i juaj, ishte faji im, nuk e thashë unë mirë pyetjen. Kur u ktheve me kerrin tënd në pozicionin B pe 2 dhe 3 jashtë kerrit, jo 1?

PË. Po.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Në rregull. Mirë tani mund të ndalojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë pushimin gjysëm ore.

Kemi pushimin e paradites, Dëshmitar. Juve do t’ju shoqërojnë jashtë sallës së gjyqit tani.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe mund të kalojmë në seancë publike. Në fakt jo. Në fakt në seancë publike jemi.

Takohemi në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 11.05

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni. Sekretare, silleni Dëshmitarin në sallë.

Dikush i bëri pyetje *[REDAKTUAR]* për të atë letrën që ka përpara Dëshmitari. Do ta paraqesim si provë materiale.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F1654*

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Meqenëse po flasim për paraqitjen e dokumenteve si prova materiale dhe më kujtoi kolegia e ZPS-së, që nuk e kam bërë ende, gjë që unë e vlerësoj, dua që këtë hartën që treguam ta paraqesim si provë materiale, gjë e cila do të ketë numrin DHT00577.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Po. DHT00577.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Ka kundërshtim që të pranohet?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo, s'ka.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga Mbrojtja? Jo.

Atëherë prova DHT00577 pranohet. Do të jepet një numër.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin 1D13.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Tani do të flas për gjëra të cilat lidhen me deklaratat e tij të mëparshme në fshatin ku ka qenë. Sepse këto deklarata kanë hollësi të tjera dhe pa diskutim do të ketë emra, venda. Nuk i shpëtojmë dot, kështu që do të na duhet të kalojmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit për informacionin.

Sekretare, të kalojmë në seancë private, ju lutem.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]*Riklasifikuar në bazë të F1654*

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, tani jemi në seancë private, sepse pyetjet e tjera që do të të bëjnë kanë, lidhen *[REDAKTUAR]*, dhe nuk kemi si ta shmangim përmendjen e emrave, vendeve që përmenden aty. Kështu që z. Moskowitz do të fillojë, do të vazhdojë me pyetjet, por doja që ta dije paraprakisht.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] I nderuar, faleminderit.

PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje për disa deklarata që ke dhënë, përpara se të dëshmosh këtu.

Deklarata që i ke dhënë në vitin, në fillim të viti 2000 ose duke e filluar nga 2000 deri në 2017, dua që të kuptosh diçka.

Këto deklarata nuk po i paraqes për të kritikuar ty. Në asnjë mënyrë. Ato që ke kaluar atë ditë ishte e tmerrshme dhe ne e kuptojmë këtë gjë. Dhe aftësia për të kujtuar me saktësi kur kalon koha gjëra që kanë ndodhur për një kohë shumë të shkurtër në një gjendje emocionale që ecën e zhvillohet me shpejtësi, kaotike është vështirë të kujtosh gjithçka që ka ndodh. Kështu që mund të ketë, është normale që mund të ketë edhe ndryshime të vogla nga një deklaratë në një tjetër. Pra, nuk e kam si kritikë. E kupton?

PË. E kuptoj.

PY. Unë kënaqem që e kupton. Deklarata e parë për të cilën do të diskutojmë është paraqitur si provë materiale me numër P90.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Do doja të shikonim faqen *[REDAKTUAR]* më anglisht dhe *[REDAKTUAR]* në shqip. E thashë gabim, ju kërkoj ndjesë, numrin. Faqja e duhur ka, në anglisht është *[REDAKTUAR]*. Ju kërkoj ndjesë. Pra, *[REDAKTUAR]*. Dhe më duket se shqipja, ja, një minutë ta gjej faqen në shqip. Faqja që është aty, po. Kjo është.

PY. E shikon këtë faqen përpara në ekran, z. *[REDAKTUAR]*?

PË. Po.

PY. Dua që të përqendrohesh, nëse mundesh, në fillim të faqes ku fillon me fjalët "Por, gjithsesi...". E shikon këtë?

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në shqip është *[REDAKTUAR]*.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Faleminderit, se nuk përkon anglishtja me shqipen.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Është në fund të faqes.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Kjo është? Sidoqoftë --

PY. Dhe një herë, në shqip, pra, është në fund. Aty ku fillon "Sidoqoftë...", dhe vazhdon edhe në faqen tjetër deri tek paragrafi që përfundon -- mbaron me fjalët "Isha anëtar i UÇK-së në atë kohë".

Më thuaj kur ta kesh lexuar, kur të përfundosh leximin.

PË. Po.

PY. [Mikrofoni çaktivizuar]

Për të mbledhur këto pikat kryesore, në këtë deklaratë,

dhe më korrigjo nëse them diçka që nuk është ashtu. Pra, ti dëgjon shtëna, del nga shtëpia. Gjëja e parë që shesh është *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* që janë brenda *[REDAKTUAR]* dhe se makina po largohej prej fshatit. Ti pe tre burra me maskë që i vinin nga pas makinës. Ti e kape njërin prej krahu dhe pe që makina ndaloi *[REDAKTUAR]*. Pastaj pe *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* që të dilnin nga makina, t'i nxirrnin nga makina dhe pasi fole me ta, e ke fjalën për *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]*, shkove me vrap në shtëpi për të marrë makinën dhe kallashnikovin. U ktheve, e more *[REDAKTUAR]* te *[REDAKTUAR]* dhe ndalojmë këtu.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj. E kuptoj që z. Moskowitz përpiqet ta orientojë dëshmitarin, por ai e sqaroi edhe këtë pjesën ku ka parë *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* që t'i nxirrnin nga makina. Ai e ka korrigjuar këtë pjesë dhe është paraqitur si provë materiale me numrin P91.

Kështu që është pak se e paqartë që Dëshmitari pyetet, ta konfirmojë kur ai e ka korrigjuar një pjesë, këtë pjesë që po e përmbledh kolegu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet. Vazhdo.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] çështje këtu është se çfarë mban mend dëshmitari për atë kohë.

PY. Pra, unë ta përmbledha këto që ka, përmban deklarata dhe e di që ke bërë dhe korrigjim siç tha Prokurorja. Por atëherë

kështu ke thënë dhe këtë deklaratë e ke nënshkruar dhe ke thënë, kështu të kujtohej në atë kohë. Është e drejtë kjo?

PË. Në aty, kur, edhe nuk e kam lexu dhe më së pari në angl -- në gjuhën angleze s'e kam kuptu. Korrigjimi që është bërë është i saktë. Korrigjimin që e ka Prokurorja tash, ky është verdikti i saktë.

PY. E kuptoj. Ke bërë korrigjim javës që shkoi. E kuptoj që ke bërë korrigjim, por ti the që s'ta lexuan atëherë kur e ke dhënë. Kështu? Je i sigurt?

PË. Ndoshta, ndoshta edhe e kanë lexu, ndoshta edhe s'e kanë lexu. S'e kam kqyrën saktë ça ka shkru. Edhe mund me ndodh ndonjë keqkuptim, keqinformim me i shkru në to. Mund me ndodhë një gabim sikur ti qe e shite 1-shin ose 5-shin, ato mund me ndodhë. Janë shumë normale. Edhe këtu ka mujt me ndodhë një diçka që nuk është kurrgjë më duket.

PY. E di. Pajtohem, është e mundur. Gabime bëhen gjithmonë. Sepse njerëz jemi dhe ti po kalon një periudhë të vështirë të jetës tënde, që duhet ta mbash mend.

Por desha që të ta freskoj kujtesën, nëse kjo deklaratë t'u lexua. Kështu që po ta lexoj.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Për qëllime referimi është *[REDAKTUAR]*.

Përkthyesi te kjo deklarata thotë, në paragrafin 2:

"Më ka informuar *[REDAKTUAR]* se flet dhe kupton gjuhën shqipe".

"E kam përkthyer me gojë deklaratën e mësipërme nga anglishtja në shqip në praninë e *[REDAKTUAR]* që duket se e ka dëgjuar dhe e ka kuptuar përkthimin tim të kësaj deklarate.

"*[REDAKTUAR]* ka pranuar se faktet që paraqiten në këtë, siç i kam përkthyer unë janë të vërtetë, me sa atij i kujtohet...".

Dhe në *[REDAKTUAR]* ka një vërtetim që thotë:

"*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*".

"I dhanë një version të deklaratës në gjuhë që ai e kupton".

Pra, nëse ta dhanë apo ta lexuan këtë deklaratë, a të kujtohet që ti e ke lexuar përpara, e ke para përpara se ta nënshkruash, apo nuk e kujton akoma?

PË. Nuk më kujtohet.

PY. Në rregull. Dua të theksoj se në këtë deklaratë që sapo e lexuam, e pamë, nuk thuhet asgjë që ke parë, tek ndonjëri nga njerëzit, burrat me maska, emblemën e UÇK-së.

PË. Atëherë, mvaret çfarë pyetje më ka bo. A më ka bo pyetje a ka pas emblemë apo s'më ka bo pyetje hiq. Edhe këtu është ai dallimi ndoshta. Varet pyetja që ma ka bo, me kon kam komuniku aty.

PY. Pra, deklarata është e hollësishme. Flet me hollësi për shumë gjëra, duke përfshirë faktin që e ke kapur prej krahu

një nga burrat me maskë. Por, nuk përmend fare ndonjë emblemë. Mund të mos ta kenë pyetur, ashtu është. Por ti vetë nuk e ke thënë gjatë intervistës?

PË. Sigurisht s’e kam thënë. S’më ka pyet edhe s’e kam thënë. Se në çdo pyetje që ma ka bo, jam munu me iu përgjigj. Edhe për këtë nuk më ka pyetun.

PY. Nuk, edhe një herë po ta përsëris. Nuk e kam për kritikë, sepse e kuptoj sa vështirë është t’i kujtosh gjërat. Sidomos atë që ndodhi atë ditë. Kështu që mos e merr si kritikë këtë që po të them. Por dua që të shohim dhe një deklaratë tjetër bashkë.

Është një deklaratë që e ke dhënë kur të ka pyetur, *[REDAKTUAR]*.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Të paraqesim në ekran *[REDAKTUAR]* në anglisht. Dhe *[REDAKTUAR]* deri në *[REDAKTUAR]*. Në shqip është e njëjta faqe. Por duam që të shohim këtë faqe që thotë *[REDAKTUAR]*, në veçanti. Po, kjo është.

PY. Dua që të shohësh, të përqendrohesh tek përgjigja që fillon me fjalët, “Jo, por...”, “Unë dua t’ju..., jo, por”. Është deklarata që tregon se çfarë ke parë kur dole nga shtëpia pasi dëgjove të shtënat e armëve.

PË. Në cilin paragraf, në cilin paragraf këtu me lexu unë? Apo do ta lexoj krejt?

PY. Aty ku fillon, përgjigjet, “Jo, por kam dëgjuar krismat dhe kam vrapuar në rrugë”. Aty, atë paragraf lexo. Dhe

paragrafin që përfundon, "E lashë prapa *[REDAKTUAR]*". "E kam lënë te *[REDAKTUAR]*". Paragrafin tjetër.

PË. Pyetjen që po bën, me përshkrimin këtu nuk po e shoh. Ose s'po e kuptoj pyetjen.

PY. Po, s'e kam bërë akoma pyetjen. Por prisja ta lexoje një herë.

PË. Okej.

PY. Po i përmbledh pikat kryesore që përshkruan këtu, pasi u largove nga shtëpia dhe që kishe dëgjuar të shtënat. Këtë e ke thënë në *[REDAKTUAR]* që është më afër ngjarjes që ka ndodhur, sesa të themi më vonë. Ti thua që pe *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* kur dole nga shtëpia. Brenda *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*. Nuk më shqetëson ngjyra e makinës, sepse e ke korrigjuar më vonë.

Po thua që pe *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* në *[REDAKTUAR]*, thu këtu. Por nuk thua që e ke parë *[REDAKTUAR]*, dhe kjo përputhet me atë që the edhe dje.

PË. Po. Veç një pyetje.

Tre vetë, tre vetë ti qysh mun me i pa në kerrin në rrugë, tuj ec kerri tëposhtë, prej anës së kundërt, ku shihen tre vetë, kur janë ul, të tretë, a mun me i pa një njeri? Kerri ka të ecë dhe prej që tujit me, të tretë, a mujsh me i pa kur jonë të ulun shpejt e shpejt? Të lutna. Këto çka janë, këto janë, këto çka je tuj thonë janë zaribancina.

PY. Pajtohem plotësisht me ty. Ti po thua atë që, tamam atë

që mendoj edhe unë. Ishte e vështirë të shikoje. Dhe sigurisht, mundësia për të parë ishte e kufizuar, e kuptojmë.

Por thua që pe ushtarë me maska. Por nuk thua asgjë që ke folur me ndonjërin apo e ke kapur prej krahu. Pajtohesh me mua?

PË. E kam folun, i kam thonë, me njonën, ku po i çoni këta të afërmit. Ka thonë veç do t'i marrim në pyetje e do t'i lëshojmë. E unë jam nis me shku ma afër ma ka drejtu armën, m'ka thonë, mos m'u afro.

PY. E kuptoj, por pyetja që po të bëj është këtu, është kjo: Nuk e ke thënë këtë gjë në deklaratë, në këtë deklaratë, që është dhënë më *[REDAKTUAR]*. Kishin kaluar *[REDAKTUAR]* mbas këtij incidenti. Thjesht po them që nuk është në deklaratë. Pajtohesh me mua që nuk është?

PË. Ndoshta nuk është edhe s'më ka bo pyetje. Varet edhe konteksti i pyetjes çfarë më ka bo, dhe çfarë pyetje më kanë bo unë iu kom përgjigjun. Ndoshta s'ma kanë bo këtë pyetje sikur ti që po e bën tash. Unë nuk muj me, një sen që s'më ka bo pyetje, me ia shtuën.

PY. Po. Gjithashtu deklarata duket sikur tregon, thotë që shkove në shtëpi për të marrë armën dhe makinën përpara se *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* të kenë dalë nga makina. Pra, ti nuk ishe aty që t'i shihje ku kanë dalë nga makina. Këtë thotë deklarata. Pajtohesh dhe a është e vërtetë kjo?

PË. Nuk më kujtohet tashti saktë. Si me to tuj zbrit apo pa

zbrit, nuk më kujtohet kjo. S'muj me thonë kurrgjë.
PY. E kuptoj, është e vështirë ta kujtosh pas kaq vitesh sidomos.
PË. Unë kur jam shku i kam pa t'zbritën të dytë edhe e kam marrë me vete *[REDAKTUAR]*, me kerr.
PY. Po, kështu thotë edhe këtu. Që e more *[REDAKTUAR]* te *[REDAKTUAR]* dhe pastaj dole nga fshati. E vë re këtu në këtë deklaratë që e ke bërë shumë herët se nuk thua asgjë që të kesh parë emblemë të UÇK-së në ndonjërin prej burrave të armatosur, më fal, me maska. Edhe pse i ke para ata, por nuk përshkruan fare që të kenë pasur ndonjë, ndonjë emblemë në sup a kështu. Nuk thotë. Pajtohesh me këtë që nuk është këtu, në këtë deklaratë?
PË. Nuk o këtu, atëherë s'ma ka bo pyetjen. Varet pyetjen, çfarë ma ka bo dhe iu kam përgjigjun. Ndoshta më ka veht veç qa ka pas vesh, i kam kallzu, a ka pas shenjë të UÇK-së nuk më ka veht bon vaki edhe s'jam kom, s'i kam dhënë përgjigje.
PY. Duhet të të kenë pyetur se çfarë kanë veshur, sepse thua këtu që ishin të veshur me uniforma të zeza. Besoj ta kanë bërë pyetjen çfarë kanë vesh, përderisa thua, ishin vesh me uniforma të zeza.
Por nuk u the vetë, me vullnetin tënd, të vet, t'i thoje.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj, për mënyrën si e përshkruan kolegu. Nuk ka informacion për bisedën e zhvilluar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet kundërshtimi.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim]

PY. Nuk është deklaratë. Pra, nuk thotë asgjë për emblemën. Me këtë pajtohesh besoj?

PË. Por në rast se nuk thotë, nuk më ka pyet edhe s'është e shkrume, nuk -- kam çfarë të them aty.

PY. Prapë, po ta përsëris. Nuk po të kritikoj. Njerëzit harrojnë; njerëzit bëjnë gabime.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] Të shohim tani deklaratën tjetër SPOE0006704-SPOE00067089. Shqipja duhet të ketë të njëjtin numër. Ajo faqja që duam të shohim është SPOE00067086.

PY. Besoj që e ke në ekran. Është, dua të lexosh aty në mes të faqes. Ajo pjesa që fillon; *[REDAKTUAR]*: "Çka ka ndodh pastaj?". E sheh këtë në mes të faqes? Ku thotë *[REDAKTUAR]*, e thotë "Çfarë ka ndodh pastaj?".

PË. Po.

PY. Ta përmbledhim, të përmbledhim pikat kryesore.

*[REDAKTUAR]*, "Na thuaj ça ka ndodh?". Dhe ti tregon këto gjërat. Pasi ke dëgjuar të shtëna, ke dalë nga shtëpia dhe një nga fshatarët të ka thënë se persona me maska e marrë *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]*. Pastaj ke shkuar në shtëpi në atë moment për të marrë veturën dhe armën.

Në këtë version këtu, shkon për në shtëpi për të marrë armen dhe veturën shumë herët pasi dëgjove nga fshatarët se çfarë i kish ndodhur të afërmve. Nuk thua asgjë që ke parë një veturë apo ke parë apo ke folur me ushtarë, apo ke folur, e ke

parë ndonjë emblemë të UÇK-së. Pastaj thua se shkon në drejtim të daljes së fshatit, sepse thua këtu që të treguan fshatarët se të afërmit e tu shkuan në atë drejtim.

Sipas kësaj deklarate nuk e ke parë as veturën as ushtarët. S’i ke parë fare. Vetëm pastaj *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* i pe afër *[REDAKTUAR]*. Dhe i more, ata të thanë që i nxorën nga makina dhe e more *[REDAKTUAR]* dhe vazhdove i ndoqe.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Ishin katër pyetje në një pyetje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është deklarata, nuk është pyetje. S’është bërë pyetja.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim] E vlerësoj vërejtjen e koleges.

PY. Por doja që të përqendroheshe dhe të përgjigjeshe. Pra, të lutem.

PË. Po përgjigjna, por nuk m’u ka bo pyetja. Ajo m’i ka bo si për shpejt e shpejt edhe nuk ma ka bo pyetjen sikur a ke dalë ma herët apo s’ke dalë. Me pa sikurse që e kam dhënë deklaratën. Varet çfarë pyetje m’ka bo. Të lutna kuptoni vetëm varet çfarë pyetje më ka bo dhe kam dhënë deklaratë. Ajo nuk më ka bo pyetje, ka ja ke majt, a ja ke majt ma [e pakuptueshme] a ja ka majt ma gat. Pyetje s’më ka bo ajo. Pyetjen që ma ka bo, iu kam përgjigj. Nuk ma ka bo këtë pyetje dhe nuk jonë cekën këtu.

PY. E vërtetë. Ata po të kërkonin që të kujtohej me sa mbaje mend çfarë kishte ndodhur. Të jepje një rrëfim të ngjarjes. Shumë e drejtë, pajtohem me ty. Dhe në fakt jua dhe rrëfimin e

asaj që kishte ndodhur me aq sa mbaje mend. Apo jo?
PË. Jo sa mbaja mend, por ndoshta më ka pyet që to edhe s'i kam cek q'aq për çdo send me i shkuen me i shkuen me ia kallzu çdo, çdo send qysh ka ndodh apo tek ka ndodhur. S'më ka bo pyetje për atë, m'ka bo, qa ke bo masanej, i kam kallzu, jam kthye, kam marrë, ato që m'ka vetë a je shkue, tek ku i ke ndjek, apo qa ka thonë. Varet krejt pyetja çfarë o bo.
PY. Mirë. Në të njëjtën intervistë, pak më poshtë, që është në faqen SPOE, pra, më falni edhe një herë, është SPOE00067087. Ndërsa shqipja e njëjta faqe, e ke para.
Nëse mund të shohësh, se kjo që do shohim mbështet atë që keni thënë ju. Në fund të faqes tek pjesa ku *[REDAKTUAR]* të kujton për veturën. A keni parë një veturë atje? E sheh këtë pjesë? *[REDAKTUAR]*:
"Kur keni dalë nga shtëpia dhe je nisur në dalje të fshatit a keni takuar veturën në të cilën ishte *[REDAKTUAR]* juaj?". Një çast.
PË. Po.
ZNJ. MAYER: [Përkthim] Është keqinterpretim i asaj që tha. E kundërshtojmë.
KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.
Z. MOSKOWITZ: [Përkthim]
PY. Këtu keni një rrëfim disi ndryshe të asaj që ka ndodhur në të vërtetë. Dhe unë nëse mundem do ta përmbledh. Nuk e lexoj dot fjalë për fjalë por më korrigjo nëse e kam gabim.

Këtu thua, po e keni parë veturën me *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* të ulur mbrapa. Pra, i ke parë të tre të ulur në ulëse e prapme. Ke parë dy ushtarë me maska në pjesën e përparme të veturës. Ke parë dy ushtarë me maska mbrapa dhe këtu përmend edhe shenjën e UÇK-së. Flet me, bisedon me njërin prej tyre, nuk thua gjë që e kapa, e rrëmb -- dhe shkon në shtëpi pastaj për të marrë veturën tënde dhe armën tënde dhe kjo është para se t'i nxirrnin *[REDAKTUAR]* dhe *[REDAKTUAR]* nga makina aty te *[REDAKTUAR]*. Pastaj takoheshim me *[REDAKTUAR]* dhe me *[REDAKTUAR]* pranë *[REDAKTUAR]* dhe ata të thonë ty që na nxorën nga makina. Kjo konfirmon faktin që s'i ke parë vetë me sytë e ty kur i nxorën nga makina.

Pra, shohim që për herë të parë, nga të gjitha deklaratat që ke dhënë këtu del shenja e UÇK-së. Dhe kjo është e *[REDAKTUAR]* këtu. Që i bie, i bie *[REDAKTUAR]* vjet pas incidentit. Në qoftë se unë e bëra llogaritjen siç duhet. A kam të drejtë?

PË. Nuk kam çka, nuk kam si të përgjigjem. Domethënë, pyetjet që m'i kanë bo, jam munu me iu përgjigj. Tasi varet në çfarë konteksti është bo krejt pyetja.

PY. [Mikrofoni çaktivizuar]

PË. Ndoshta edhe përkthyesi, përkthyesi nuk ka ditë edhe me përkthy në atë kohë. Ku ta di unë. Edhe s'e kam lexu fjalë për fjalë. Nuk e kam lexu çfarë kam nënshkru deri në fund. Ndoshta mun me pas edhe gabime këtu, dorëshkrim, domethënë që e kanë bo.

PY. E kuptoj këtë. Po dua të theksoj që kjo që po bëjmë tani, nuk është për të qortuar por vetëm për të të treguar se ndonjëherë kujtesa na gënjen. Ndonjëherë i harrojmë ca gjëra. Ose ndonjëherë nuk i mbajnë mend saktë në hollësi ca gjëra, sepse situata ka qenë kaotike. Gjërat ndryshonin shumë shpejt. Dhe besoj se pajtohesh me mua se ka disa mospërputhshmëri mes deklaratave.

ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kundërshtoj pyetjen. Por z. Moskowitz i tha Dëshmitarit, i bëri një fjalim për kujtesën. Kështu që, besoj se ky shpjegim merret parasysh po mendoj që ai duhet ta përfundojë të gjithë fjalinë e vet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtohet. Vazhdoni.

Z. MOSKOWITZ: [Përkthim]

PY. A mendoni se ka mundësi ta keni gabim për emblemën, shenjën e UÇK-së, se s'e mban mend apo që kujtesa jote ka ndryshuar sepse ke biseduar me persona të ndryshëm gjatë viteve, ça ke parë ti, ça kanë parë ata e të kujtohet gjërat ndryshe, a ka mundësi të jetë edhe kështu?

PË. Jo.

PY. A njihni ndonjë dëshmitar tjetër okular në vendngjarje, e dini që, më falni një çast. A njihni dëshmitarë të tjerë okularë në vendngjarje që nuk kanë parë burra të maskuar që mbanin simbolet e UÇK-së? E dinit këtë? Jeni në dijeni të kësaj? Dëshmitarë të tjerë --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

[Përkthim]

Mbaroje pyetjen siç duhet dhe pastaj do marrësh përgjigjen.

